

VENDIM
Nr. 194, datë 19.6.2023

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ 2023 PËR KLIENTËT E
LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1732/1 prot., datë 9.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 4357 prot., datë 1.6.2023, protokolluar me tonën me nr. 1732 prot., datë 5.6.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a. vihet re, se shoqëria vijon të përfshijë ndër të tjera edhe kostot e imbalancave në përllogaritjen e çmimit (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca). ERE, sikurse referuar edhe shkresës nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, në mënyrë të përsëritur ka sqaruar shoqërinë, se bazuar në nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e livrimit. Mbi këtë tarifë do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktohet në metodologji, kostot e imbalancave do të llogariten dhe do të faturohen në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përllogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2023		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	12.57
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.38
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 16.41

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 16.41 lekë/kwh për muajin maj 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin maj 2023, prej 16.41 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti